



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 21/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e z. Lutfi Haziri, nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seancën e mbajtur me 2. 11. 2009, mori:

### VENDIM

Pranohet ankesa si e bazuar.

Subjekti politik Partia Social Demokrate (PSD) është përgjegjëse për shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” Nr. 11/2009, neni 3 pika (a) për çka i shqiptohet gjoba në shumën prej 530 Euro, të cilën detyrohet të i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Sekretariatën e KZAP-it për tu përcjellë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

### ARSYETIMI

Subjekti politik LDK ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se partia politike PSD, më datë 20.10.2009, në Prizren, ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 33 shkronja (a) i cili në bazë të nenit 15 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, *mutatis mutandis* vlenë edhe për zgjedhjet lokale, neni 3.1 shkronja (a) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009 – Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

### FAKTET

Më 21.10.2009 Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë nga Shefi i Shtabit Zgjedhor të LDK-së, Lutfi Haziri, ku deklarohet se PSD ka bërë shkeljen e Rregullave dhe Kodit të Mirësjelljes (Nr.11/2009), neni 4 bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 33 shkronja (a) dhe neni 3.1 shkronja (a) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009 - Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga veprimet si në vijim:

*Heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik”;*

KZAP-i të bashkangjitur ka pranuar fotografimet e shkeljeve të pretenduara nga vendi i ngjarjes, gjegjësisht vendosjes së posterave të kandidatit të PSD-së mbi posterat e kandidatit të LDK-së në Prizren, në rrugët “Rrasat e Koshares” dhe “Adem Jashari” në Prizren.

KZAP informoi PSD-në me 22 Tetor 2009 rreth ankesës dhe i dha mundësi të përgjigjej bazuar në pajtim me nenin 4.3. të Rregullores së Punës të KZAP-it. KZAP mori përgjigje nga PSD-ja brenda afatit të 28 Tetor 2009, të vendosur nga KZAP.

**ANALIZA**

Jurisdiksioni i KZAP’it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009, neni 3.6 parasheh:

*3.6 Cilido subjekt politik i certifikuar duhet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin subjekteve të tjera politike të certifikuara.*

Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 2 parasheh:

- 2.3 Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.*
- 2.4 Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.*
- 2.5 Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre;*

Është e qartë se Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009, neni 3.6 dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 2.3, 2.4 dhe 2.5 zbatohet për Subjektet Politike. Është njësoj e qartë se në rastin në fjalë, ka ndodhur një shkelje të këtyre dispozitave të lartcekura. Ndërsa nuk njihet identiteti i kryesit faktik të këtyre shkeljeve, dihet se PSD-ja është në kontroll të përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve të saj të fushatës.

PSD-së iu dha mundësia të jepte shpjegimet e saj për ngjarjen, gjë që e ka bërë më datë 28.10.2009. Prandaj, në përgjigjen nga PSD, kjo parti ka kërkuar falje për shkeljet e bëra nga një aktivist i tyre. KZAP-i nuk ka informacione të tjera prej të

4

cilave të interpretonte provën fotografike, e cila tregon qartë shembuj të shumtë kur postera të PSD-së vendoseshin sipër posterave të LDK-së.

Edhe sikur PSD të mos ishte vetë përgjegjëse për këto shkelje, duket se PSD nuk ka ushtruar përpjekje të arsyeshme për të mbikëqyrur shpërndarjen e materialeve të saj të fushatës. Gjithashtu, megjithëse KZAP-i dha mundësinë të shpjegonte se si i kishte marrë të gjitha masat për të qenë në pajtim me Rregullat Zgjedhore, ajo nuk ka dhënë në mënyrë specifike këtë informacion. As nuk ka dhënë ndonjë informacion organizativ prej të cilit KZAP-i të konkludonte se shpërndarja e materialit ishte mbikëqyrur në mënyrën e duhur. Nga mungesa e një informacioni të tillë, KZAP-i arriti në përfundim se PSD ose nuk ka adaptuar ndonjë masë siç kërkohet sipas Rregullit Zgjedhor Nr. 13/2009, neni 3.6, ose ka adaptuar masa të pamjaftueshme.

Duke vendosur për gjobën që do të vihet në këtë lëndë, KZAP-i ka marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

1. Se shkelja në këtë rast ka të bëjë me postera dhe jo me stenda të mëdha afishimi apo objekte të ngjashme ekspozimi;
2. Se shkelja ka ndodhur në më shumë se një vend;
3. Se PSD ka marrë pjesë në zgjedhjet e kaluara;
4. Se PSD i është përgjigjur kërkesës së KZAP-it për të dhënë shpjegime lidhur me rrethanat.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

A nr. 21/2009 më datën 2.10.2009.

